

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Industria nxjerrëse në Shqipëri shënoi turrje gjatë vitit 2025
ADRESA	https://www.reporter.al/2026/09/28/industria-nxjerrrese-ne-shqiperi-shenoi-turrje-gjate-vitit-2025/
BURIMI	reporter.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 11:23:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 1800 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 10:57:55 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b3d99a44c2197521b5b14151f9f4da58318397ad42956c517b1e3850c953acd4
TEKSTI	c4e0c0715e17558876f796331b7444d5883ea13b404f389d564a41695cef54c9
PAMJA	f60e00a14d716fe67afa6a248a08e54e81567473561dd1ca308486fc0057425d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e0f9a2088814eb0d9da97b03a6f38f5e557ae3c21d6b2ae3ff5240b18abef9ea
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b4355a68894c65a63b1e90d1f962746a91a9c18b00f6b0772c3894db0f3539f0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon një rën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e0f9a2088814eb0d9da97b03a6f38f5e557ae3c21d6b2ae3ff5240b18abef9ea>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TEMA:

BELINDA BALLUKU

ERION VELIAJ

VETING

SPAK

MJEDISI

EDI RAMA

SALI BERISHA

ZGJEDHJE 2025

Kryefaqja Lajme

Industria nxjerrëse në Shqipëri shënoi turrje gjatë vitit 2025

Prodhimi i çimentos, betonit, bukës dhe sistemeve elektrike për automjete u rrit gjatë vitit 2025, ndërsa industria nxjerrëse regjistroi rënie të fortë të shitjeve të naftës bruto dhe kromit, sipas të dhënave të publikuara të hënën nga INSTAT.



nga BIRN — 17 seconds më parë në Ekonomia, Lajme Koha e leximit: 2 min lexim

AA

0



Ish-kombinati i Përpunimit të Thellë të Naftës në Ballsh u shit për t'u çmontuar për skrap. Foto: Nensi Bogdani/BIRN.

Prodhimi industrial në Shqipëri dha sinjale të përziera gjatë vitit 2025, me rritje në industrinë e materialeve të ndërtimit, ushqimore dhe pjesëve për automjete, por me turrje të ndjeshme në disa prej produkteve kryesore të industrisë nxjerrëse.

Sipas Anketës së Produkteve Industriale, të publikuar të hënën nga Instituti i Statistikave, prodhimi i çimentos Portland arriti në rreth 1.99 milionë tonë, ose 2.5 për qind më shumë se një vit më parë, ndërsa prodhimi i betonit të gatshëm u rrit me 3.5 për qind, në 1.77 milionë tonë.

Rritje më të fortë shënuan sistemet e fijeve elektrike të izoluar për automjete, prodhimi i të cilave u shtua me 8.7 për qind, si dhe buka e freskët, me një rritje prej 8.4 për qind.

Të dhënat tregojnë gjithashtu një rritje të vlerës së shitjeve për disa produkte të lidhura me ndërtimin. Shitjet e llaçit të prodhuar në fabrikë u rritën me 19.5 për qind, ndërsa ato të aluminit të lidhur të papërpunuar me 15.4 për qind. Shitjet e bukës së freskët u rritën me 11.1 për qind dhe ato të ujit mineral dhe të gazuar me 8 për qind.

Por pamja e prodhimit 'Made in Albania' ishte më negative për industrinë nxjerrëse.

Vlera e shitjeve të naftës bruto ra me 24.3 për qind, ndërsa ajo e xehërorëve dhe koncentreve të kromit u turr me 23.9 për qind krahasuar me vitin 2024.

Sipas INSTAT prodhimi i naftës bruto ra nga 716 mijë tonë në vitin 2024 në 634 mijë tonë në 2025, ndërsa vlera e shitjeve zbriti nga 29.9 miliardë lekë në 22.6 miliardë lekë. Prodhimi i kromit ra nga 588 mijë në rreth 503 mijë tonë, ndërsa vlera e shitjeve u zvogëlua nga 14.9 miliardë në 11.4 miliardë lekë.

Në të kundërt, shitjet e çimentos qëndruan pothuajse të pandryshuara në rreth 19.4 miliardë lekë, ndërsa ato të betonit të gatshëm u rritën nga 13 miliardë në 13.7 miliardë lekë. Sistemet e fijeve elektrike për automjete krijuan rreth 9.5 miliardë lekë shitje, nga 8.7 miliardë një vit më parë.

Sipas INSTAT, industria ushqimore vijoi të kishte peshën më të madhe në shitjet e produkteve industriale, duke zënë 16.4 për qind të totalit. Ajo pasohet nga prodhimi i produkteve minerare jo metalike me 14.4 për qind dhe metalurgjia me 8.4 për qind.

Industria nxjerrëse në Shqipëri shënoi turrje gjatë vitit 2025

12:57 | 28/09/2026

Një klikim, mijëra lekë: Si po bien shqiptarët në grepin e 'mashtimit kompjuterik'

07:59 | 28/09/2026

Evropa duhet të zgjedhë mes fuqisë dhe varësisë

19:00 | 27/09/2026

Arbëreshët e Sicilisë: një identitet shekullor që po zbehet

07:18 | 27/09/2026

Kur populli e bojkoton shkrimtarin, para se shkrimtari të bojkotojë popullin

14:44 | 26/09/2026

Republika e sofizmave

08:03 | 26/09/2026

Reporter.al

Opinion
Reportazhe
Analiza
Investigime
Lajme
Blog
Rajoni

Rreth nesh
Stafi
Kontakttoni
Ankesa dhe Korrigjime
Politika e privatesise dhe
rregulla te tjera
Letra per redaktorin

Follow Us



Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

© 2014 - 2026 Reporter.al - BIRN

Dev by [Sfida.PRO](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.